

VENDIM
Nr.522, datë 11.12.1992

**PËR CAKTIMIN E SIMBOLIT DALLUES TË KRYETARIT TË KOMUNËS OSE TË
BASHKISË**

Në mbështetje të nenit 33 të ligjit nr.7572, datë 19.6.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Modeli i simbolit dallues të kryetarit të komunës ose të bashkisë të jetë shirit mëndafshi me ngjyrat e flamurit kombëtar kuq e zi dhe me përmasat 9 cm gjerësi (tre shirita nga 3 cm secili, një i zi që vendoset mes dy shiritave të kuq) dhe 1.6 deri në 2 m gjatësi. Shiriti vendoset krahëqafë nga supi i djathtë drejt ijës së majtë, i lidhur në fund në formë kordeleje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi